



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 176 prot.

Kamëz, më 09.12.2022

V E N D I M
Nr. 157 .Datë 09/12 2022
M B I

“MIRATIMIN E LISTËS SHITESË SË SUBJEKTEVE, POSEDUES TË NDËRTIMEVE PA LEJE QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT NDËRTIMI I PEDONALES DHE ZONAVE REKREATIVE TË PARKUT TË LIQENIT TË PASKUQANIT, TË CILËT PËRFITOJNË SUBVENCIONIM TË QIRASË SIPAS PARASHIKIMEVE TË VKM NR. 409, DATË 15.06.2022 “PËR RREGULLAT, MËNYRAT DHE AFATET E TRAJTIMIT TË POSEDUESVE TË NDËRTIMEVE PA LEJE QË NUK LEGALIZOHEN”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 09.12.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.133 Datë 09.12.2022 në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji nr.44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative së Republikës së Shqipërisë”; Ligji nr.22/2018 “Për strehimin social”; Ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proçeseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”; VKM nr.409, datë 15.06.2022 “Për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve pa leje që nuk legalizohen”; Urdhër i Kryetarit të Bashkisë Kamëz me nr.945 prot, datë 06.11.2022 “Për ndjekien dhe trajtimin e poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen dhe që preken nga realizimi i projektit ndërtimi i pedonales dhe zonave rekreative të parkut të liqenit të paskuqanit”, Vendimi Nr.133, Datë: 22.12.2021, si dhe Vendimi Nr.01, Datë: 27.07.2022 “Për Miratimin e Planit të Përgjithshme Vendor Bashkia Kamëz”; VKB nr.145, datë 25.11.2022 “Për miratimin e vlerës së subvencionimit të qirasë për familjet që preken nga projekti “Rehabilitimi i digës së liqenit të paskuqanit dhe ndërtimi i pedonales dhe zonave rekreative të liqenit të Paskuqanit”; VKB nr.146, datë 25.11.2022 “Për miratimin e listës së familjeve që përfitojnë bonus qiraje banesat e të cilëve preken nga projekti “Rehabilitimi i digës së liqenit të paskuqanit dhe ndërtimi i pedonales dhe zonave rekreative të liqenit të Paskuqanit”; **Këshilli Bashkiak Kamëz”;**

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës së subjekteve përfitues për bonus qiraje për familjet që preken nga zbatimi i projektit **“Ndërtimi i pedonales dhe zonave rekreative të parkut të liqenit të Paskuqanit”**.
2. Subjektet përfitues do të trajtohen në formën e bonusit të qirasë për një afat 3-vjeçar nga momenti i firmosjes së marrveshjes dhe lëshimit të godinës së banimit duke zbatuar nivelin e qirasë për frymë sipas **VKB nr.145, datë 25.11.2022 “Për miratimin e vlerës së**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

subvencionimit të qirasë për familjet që preken nga projekti “Rehabilitimi i digës së liqenit të paskuqanit dhe ndërtimi i pedonales dhe zonave rekreative të liqenit të Paskuqanit”

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Grupi i Punës i referuar si më poshtë.
Lista e subjekteve të cilët përfitojnë trajtimin financiar në formën e bonusit të qirasë paraqitet në aneksin bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

KRYETAR KËSHILLI

Hysen KOLDASHI



SUBJEKTET PËRFITUES

Nr.	Emër	Mbiemër
1	Gjevalin	Pepa
2	Bedrije	Selimaj
3	Florin	Abdyli
4	Besmir	Balavija
5	Xhevat	Balavija
6	Alfred	Cera
7	Hektor	Buci
8	Agron	Shupli
9	Fate	Gjuta
10	Met	Metallari
11	Flanxa	Metalia
12	Xhevahire	Duraku
13	Manushaqe	Duraku
14	Flanur	Krasniqi
15	Ajdin	Krasniqi
16	Perparim	Gashi
17	David	Perdoda
18	Jashar	Haldeda
19	Rabije	Koloshi
20	Bardhyl	Gashi
21	Roshi	Sena

KRYETAR KESHILLI
HYSEN KOLDASHI

